

BE për migracionin në Shqipëri (EU4Migration)**Duration:** 01.01.2025 - 31.12.2028**Countries:**
Albania**EU contribution:** € 10 000 000**Total budget:** € 10 000 000**Social media:**<https://albania.iom.int/eu4migration-albania>**Website(s):** unhcr.org/europe/eu4migration-albania**Project description:**

"BE për migracionin në Shqipëri" është një iniciativë katërvjeçare, i cila zhvillohet që nga janari i vitit 2025 deri në dhjetorin e vitit 2028. Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga IOM dhe UNHCR, në bashkëpunim të ngushtë me qeverinë shqiptare. Projekti synon të forcojë sistemet e migracionit dhe të azilit në Shqipëri në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, duke mbështetur procesin e anëtarësimit të vendit në BE.

Iniciativa fokusohet në përmirësimin e menaxhimit të kufirit, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe të veprimit, si dhe rritjen e mbrojtjes e ofrimit të shërbimeve për migrantët, azilkërkuesit dhe refugjatët. Po ashtu, ky projekt mbështet qasjen gjithëpërfshirëse në shërbime sociale dhe ekonomike, integrimin në nivel komuniteti dhe mbledhjen dhe analizën më të mirë të të dhënave të migracionit për të informuar hartimin e politikave të bazuara në prova. Disa nga fushat e ndërhyrjes përfshijnë: forcimin e qeverisjes, të politikave dhe të mekanizmave të koordinimit për migracionin dhe azilin; përmirësimin e kapaciteteve teknike dhe operacionale për menaxhimin e kufirit dhe pritjes me standarde mbrojtjeje, si dhe mbështetjen e përfshirjes së migrantëve, azilkërkuesve dhe refugjatëve në sistemet dhe shërbimet lokale.

Projekti mbështet Strategjinë Kombëtare për Migracionin 2024–2030, duke adresuar nevojën për menaxhim të përmirësuar të flukseve të përziera të migracionit. Kjo iniciativë është kritike për përmbushjen e kërkesave në kuadër

Expected results:

- qeverisja e migracionit dhe azilit në Shqipëri është forcuar, në mbështetje të procesit të anëtarësimit në BE.
- autoritetet në Shqipëri konsolidojnë kapacitetin teknike dhe operacionale për menaxhimin e migracionit dhe azilit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së;
- migrantët, azilkërkuesit dhe refugjatët përfshihen në shërbimet sociale dhe ekonomike lokale.